



Në bazë të nenit 2 . paragrafi 2.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr . 2000/45 për Vetëqeverisjen e Komunave , dhe duke u bazuar në Statutin e Kuvendit Komunal të Suharekës, Kuvendi i Komunës së Suharekës në mbledhjen e vet të mbajtur me datë 28.12.2005, nxjerr këtë:

RREGULLORE

PËR

**FILLIMIN DHE MBARIMIN E ORARIT TË PUNËS NË LËMIN E EKONOMIS
,TREGTIS ,ZEJTARIS DHE TË SHËRBIMEVE TË TJERA NË TERRITORIN E
KOMUNËS SË SUHAREKËS**

I Dispozitat e përgjithshme

Neni 1.

Me këtë Rregullore përcaktohet fillimi, mbarimi dhe respektimi i orarit të punës të subjektet tregtare , hoteliere ,të zejtarisë,ndërtimtarisë , prodhimtari dhe shërbimeve të tjera në territorin e Komunës së Suharekës, në bazë të nevojave dhe kërkesave të punonjësve dhe të qytetarëve .

Neni 2.

Të gjitha subjektet afariste të themeluara në pajtim me Ligjin dhe dispozitat e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/6 për shoqëritë aksionare , bizneset individuale , ortakëritë etj. janë të obliguara ti përmbahen orarit të punës , të përcaktuara me këtë rregullore .

Neni 3.

3.1. Subjekti është i obliguar të theksoj orarin e punës në hyrje apo në vende të dukshme të objektit në të cilën kryhet veprimtaria, në përputhje me këtë rregullore, duhet saktësuor orarin e punës para dite, pasdite, orarin e pushimit ditor si dhe ditët që nuk punohet .

3.2. Për raste të jashtëzakonshme (dasma , vdekje etj.) që nuk punohet të vendoset (theksohet në vend të dukshëm) informacioni se “subjekti nuk punon” deri në datën e caktuar , për arsye të caktuar.

3.3. Orarin e ekspozuar për punë dhe pushim subjekti duhet ta respektojë .

II. KOHA E PUNËS

Neni 4 .

Përcaktohet orari i punës në interval kohor :

4.1. Orari i punës i subjekteve zejtare fillon prej orës ----- 07.00 deri në ora 20.00

- 4.2. Orari i punës i vetëshërbimeve, super marketëve, dyqaneve tregtare:
 ----- 07.00 deri në ora 22.00
- 4.3. Restorantet, ëmbëltoret, kafe-baret, internet-kafet, disko-klubet e të ngjashme do të punojnë 7 ditë në javë prj ores----- 07.00 deri në ora 24.00
- 4.4. Klubet e natës do të punojnë ditëve: të premte, të shtune dhe të dielën,
 ----- me këtë orar: prej orës -- 23.00 deri në ora 05.00
- 4.5. Tregu i plaçkave: prej orës ----- 07.00 deri në ora 17.00
- 4.6. Tregu i kafshëve dhe i automobilave: prej orës ----- 07.00 deri në ora 15.00
- 4.7. Barnatoret do të punojnë me këtë orar: prej orës ---- 07.00 deri në ora 20.00
- 4.7.1 Obligohet që së paku një barnatore të punoj nën stop 7 ditë në javë, barnatorja e cila duhet të kujdestarohet, do ta caktoj Drejtoria për Ekonomi dhe Financa në bazë të kritereve të veta.
- 4.8. Klinikat dhe ordinancat shëndetësore në sektorin privat do të punojnë me këtë orar
 ----- 08.00 deri në ora 21.00
- 4.9. Qendra për mjekësi familjare do të punon 7 ditë në javë ---- non stop 24 orë
- 4.10. Objektet (pompat e benzinës)për shitjen e karburanteve do të punojnë në këtë orar:
 prej ores ----- 06.00 deri në ora 24.00
- 4.11. Hotelet , motelet do të punojnë: punojnë 7 ditë në javë ----- non stop 24 orë .
 VËREJTJE : Pas orës 24.00 nuk lejohet shërbimi i mysafirëve jashtë objektit të hotelit , motelit .
- 4.12. Furrat e bukës do të punojnë -----prej orës 00 deri në ora 24
- 4.12.1 Të dielave furrat e bukës do të punojnë deri në ora 10.00
- 4.13. Ndërmarrjet tregtare, ndërtimore dhe të ngjashme do të punojnë prej orës
 ----- 07.00 deri në ora 18.00
- 4.14. Subjektet prodhuese do të punojnë ----- non stop 24 orë
- 4.15. sallonet e bukuriisë do të punojnë prej orës ----- 06 deri në ora 18

Neni 5

Subjektet të cilat dëshirojnë të punojnë gjatë ditëve të vikendit duhet të marrin leje të veçantë nga Drejtoria për Ekonomi dhe Financa , Drejtoria për Ekonomi dhe Financa është e obliguar ta njoftoj me shkrim Drejtorin e Inspeksionit për çdo leje të dhënë.

Drejtorja për Ekonomi dhe financa mund të lëshoj leje duke marrë për bazë kriteret që të përfshinë të gjitha lagjet e qytetit:

- dy pompa benzine me pagesë 100.00 Euro në muaj
- katër markete ushqimore 100.00 Euro për muaj
- ndërmarrjet ndërtimore 100.00 Euro për muaj

Të gjitha ato subjekte që shprehin dëshirë dhe nevojë për të punuar ditëve të vikendit mund të bëjnë kërkesë Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa e njëjta do të shqyrton kërkesën dhe mund të jep leje me pagesë nga ai subjekt prej 50-100 Euro në muaj

Neni 6

Të dielën nuk punohet (ditë pushimi), përveç: subjekteve të cekura në nenin 4.3, 4.9, 4.11, 4.14, 4.15.

Neni 7

Në objektet hoteliere të cilat gjenden në afërsi të objekteve të banimit e në të cilat organizohet program i gjallë muzikor apo me audio – video mjete për reproduktimin e programit, programi nuk mundë të mbahet pas orës 23.00
Me „afërsi të drejtpërdrejtë“ kuptohet largësia 100m. nga objekti i banimit .

Neni 8

Veprimtaritë e lartpërmendura në nenin 4.3, 4.4, 4.11 dhe 4.14, gjatë orarit të punës nuk mundë tu prishin qetësin e qytetarëve që banojnë në afërsi të tyre, qoftë me muzikë apo me forma të tjera .

III. Ndryshimi i orarit të punës

Neni 9

Të gjitha subjektet e përfshira në nenin 4.1, 4.2, 4.3, 4.4, 4.8 dhe 4.13 mund të punojnë më gjatë se orari i paraparë me këtë rregullore, me lejen të veçantë të cilën duhet marrë nga Drejtoria për Ekonomi dhe Financa dhe për çdo leje të dhënë, Drejtoria për Ekonomi dhe Financa obligohet ta njoftoj me shkrim Drejtorin e Inspektionit.

Për çdo orë pune më gjatë se orari i punës duhet paguar :

- objektet hoteliere (restorantet , kafe- baret , dyqanet hoteliere).....20.00.Euro .
- supermarketet vetëshërbimet 15.00Euro .
- dyqanet tregtare 10.00 Euro
- ndërmarrjet ndërtimore 20.00 Euro
- ordinancat private 10.00 Euro

Neni 10.

Subjektet afariste mundë të zgjasin orarin e punës si në rastet :

- për festat kombëtare 28 Nëntorin ----- deri në orën 03.00
- për festat fetare, bajrami i madh dhe bajrami i vogël, kërshëndellat , pashkët, karnavale, etj . deri në ora 03.00
- për festat e shënvalentinit deri në ora 03.00
- për festen e vitit të ri deri në ora 05.00
- për ditën e çlirimit të Suharekës deri në ora 03.00

Për këto festa nuk duhet kërkuar pëlqimin nga Drejtoria e Ekonomisë dhe Financa.

IV. Dispozitat ndëshkuese

Neni 11

Të gjitha subjektet që nuk e respektojnë dispozitat nga neni 3 të kësaj rregullore , do të dënohen për kundërvajtje : prej 100 deri ..200 Euro.

Neni 12.

Të gjitha subjektet afariste të cilat nuk do të respektojnë fillimin dhe mbarimin e orarit të punës të paraqitur në nenin 4 i cili do të konstatohet nga Inspektori apo policia , do të dënohet për kundërvajtje :

-personat juridik250. deri350.Euro

- personat fizik120. deri250. Euro

Neni 13.

Të gjitha subjektet afariste te të cilat do të konstatohet se kanë zgjatur orarin pa leje nga Drejtoria për Ekonomisë e Financave si në nenin 9, do të gjobiten për kundërvajtje :

-personi juridik250. deri350. Euro

-personi fizik120 deri250 Euro

Neni 14

Nëse bëhet shkelja e dispozitave të nenit 7 dhe 8 do të dënohet për kundërvajtje

- personi fizik 100 Euro

- personi juridik 200 Euro

V. Dispozitat kalimtare dhe të fundit

Neni 15.

Për zbatimin e kësaj Rregullore do të kujdeset Drejtoria për Ekonomi e Financa , ndërsa mbikëqyrjen do ta bëjë Drejtoria e Inspektionit dhe Policia .

Neni 16.

Personat juridik , gjegjësisht subjektet afariste janë të obliguar që të harmonizojnë orarin e punës me dispozitat e këtij Vendimi, ditën e nesërme nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Rregullore

Neni 17.

Me ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregullore ç'fuqizohet çdo vendim i mëparshëm Komunal që ka rregulluar fillimin dhe mbarimin e orarit të punës për subjektet afariste .

Neni 18.

Kjo Rregullore hynë në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit Komunal të Suharekës.

KUVENDI I KOMUNËS – SUHAREKË

01.Nr _____

Suharekë dt. _____

Kryetari i Kuvendit

Sali Asllanaj

